



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202003362/3

Tiranë ___/___/2021

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin me rigorozitet të kriterëve të shoqërimit të shtetasve në organet e Policisë së Shtetit dhe respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar.*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Tiranë

Për dijeni: **MINISTRISË SË BRENDSHME**
Tiranë

Të nderuar,

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të shtetasve ndoqi me vëmendje të veçantë protestat e zhvilluara në qytetin e Tiranës nga grupime qytetarësh, kryesisht të rinj nga data 09.12.2020 e në vijim. Sikurse u bë publike nga media këto protesta qenë shprehje e indinjatës së qytetarëve për shkak të vrasjes së shtetasit Klodian Rasha nga një punonjës policie efektiv i Forcës së Posaçme "Shqiponja" të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Avokati i Popullit ka shprehur qëndrimin e tij në lidhje me ushtrimin e të drejtës/lirisë së tubimit nga qytetarët si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Sjellim në vëmendje se liria e

tubimeve është parashikuar dhe garantuar nga neni 47 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe neni 11 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kufizimet e vendosura ndaj të drejtave dhe lirive themelore të njeriut sikurse është dhe liria e tubimit nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut¹ (KEDNJ) e interpretuar nëpërmjet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), duke paravendosur si kusht që këto kufizime të jenë proporcionale me gjendjen që e ka shkaktuar nevojën për vendosjen e tyre. Shteti ka diskrecion për të konstatuar domosdoshmërinë e kufizimit të një apo disa të drejtave në përputhje me rrethanat që diktojnë këtë nevojë, duke mbajtur në vëmendje deri në ç'masë është e nevojshme të vijohet me kufizimet në përpjekje për të kapërcyer gjendjen e emergjencës².

GJEDNJ në praktikën e saj ka konsideruar se njoftimi, dhe madje procedurat e autorizimit, për një ngjarje publike normalisht nuk shkelin mbi thelbin e së drejtës në bazë të nenit 11 të Konventës për sa kohë që qëllimi i procedurës është që të lejojë autoritetet të marrin masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të garantuar zhvillimin normal të çdo tubimi, mbledhje apo grumbullimeve të tjera³. Organizatorët e tubimeve publike duhet të veprojnë në përputhje me rregullat që rregullojnë këtë proces duke respektuar rregulloret në fuqi. Njoftimi paraprak i shërben jo vetëm qëllimit të bashkërendimit të të drejtës së tubimit me të drejtat dhe interesat e ligjshëm duke përfshirë lirinë e lëvizjes të të tjerëve, por gjithashtu qëllimit të parandalimit të trazirave apo krimit. Edhe në rastin kur nuk është bërë një lajmërim paraprak për protestë, ky element teknik nuk duhet të shkelë kurrësi thelbin e së drejtës për ta ushtruar lirinë e tubimit.⁴

Rregullat procedurale që disiplinojnë apo kushtëzojnë ushtrimin e kësaj të drejte janë të përcaktuara në mënyrë të shprehur në ligjin nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet”, ku parashikohen edhe kufizimet apo ndalimet shteruese të cilat nuk mund të tejkalohen në ushtrimin e së drejtës së tubimit. Ky ligj pasi përcakton se, çdo person ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në një tubim paqësor dhe pa armë, parashikon gjithashtu se Policia e Shtetit garanton dhe mbron të drejtën e çdo personi për të organizuar e marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë. Ndalimi dhe shpërndarja e një tubimi lejohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj. Nga referimi në përmbajtjen e dispozitave të këtij ligji rezulton se për ushtrimin e kësaj të drejte kërkohet vetëm bërja e njoftimit në një kohë të përcaktuar i organeve të policisë ku të pasqyrohen disa të dhëna që lidhen me zbatimin e detyrës së saj si garantuese e ushtrimit të kësaj të drejte duke i dhënë kohe për të marrë masat e nevojshme për mbarëvajtjen e tubimit.

Përveç dispozitave të cituara më sipër, duke i referuar nenit 15/2 të Kushtetutës dhe nenit 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Avokati i Popullit vlerëson se nga organet e pushtetit

¹ Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

² Me notën verbale të Misionit Permanent të RSH pranë Këshillit të Evropës, të datës 31 Mars 2020, shteti shqiptar, në përputhje me nenin 15/3 të KEDNJ, i ka njoftuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës derogimin nga disa të drejta të parashikuara nga nenet e Konventës, për shkak të gjendjes së epidemisë. Ndërkohë afati për të cilin është bërë derogimi ka rënë dhe aktualisht ai e ka humbur fuqinë ligjore.

³ Shih, *Sergey Kuznetsov kundër Rusisë*, nr. 10877/04, § 45, 23 tetor 2008.

⁴ Shih, *Éva Molnár kundër Hungarisë*, 7 tetor 2008, kërkesa nr. 10346/05.

publik kërkohet që, jo vetëm të mos bëhen pengesë për ushtrimin e lirisë së tubimeve të shtetasve, por përkundrazi duhet të kontribuojnë në realizimin e saj.

Në përfundim të shqyrtimit të disa rasteve që lidhen me ushtrimin e kësaj të drejte dhe me qëllim për t'u krijuar lehtësi shtetasve për realizimin e të drejtave të tyre kushtetuese e ligjore, por edhe për të unifikuar qëndrimin e organeve të Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe atyre gjyqësore në të tilla raste, kemi vlerësuar se strukturat kompetente shtetërore duhet të përmirësojnë aktet normative që rregullojnë lirinë e tubimit, me qëllim që ajo të ushtrohet edhe në rastet e pandemisë sikurse ndodhet vendi ynë aktualisht. Avokati i Popullit ka shprehur qëndrimin e tij që gjatë procesit të përgatitjes së këtyre akteve nga organet kompetente duhet të mbahen parasysh vendi se ku do të zhvillohet tubimi, i mbyllur apo i hapur, sipërfaqja e tij, numri i pjesëmarrësve, masat mbrojtëse ndaj përhapjes së infeksionit, parimi i rëndësishëm i proporcionalitetit, etj.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, në vijimësi ka përgatitur rekomandime drejtuar institucioneve qendrore të administratës publike, nëpërmjet të cilave ka rekomanduar:

1. Marrjen e masave të nevojshme për ndërprerjen e menjëhershme të praktikës së deritanishme të strukturave të Policisë së Shtetit për moslejimin e grumbullimeve jo masive në vende të mbyllura apo të hapura, si tubime dhe dëgjesa publike, organizuar nga subjekte të ndryshëm gjatë periudhës së kohëzgjatjes së pandemisë dhe të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.
2. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat përkatëse për të bërë propozimet konkrete drejtuar organeve që kanë të drejtën e nismës legjislative për të mundësuar ndryshimet në ligjin nr. 8773, datë 23.4.2001 "Për tubimet", për të garantuar të drejtën e tubimeve spontane si dhe antiprotestat në përputhje me rekomandimet dhe aktet ndërkombëtare.
3. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e Policisë së Shtetit për të garantuar të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga gazetarët e pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.
4. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e pushtetit publik për përmirësimin e akteve normative në fuqi që rregullojnë lirinë e tubimit me qëllim garantimin e kësaj të drejte kushtetuese edhe në periudha pandemie dhe të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, duke respektuar protokollat përkatës shëndetësorë.
5. Përgatitjen dhe miratimin e një udhëzimi apo qarkore nga Prokuroria e Përgjithshme, në bashkëpunim me KLP dhe KLGJ për unifikimin e praktikave të organeve të prokurorisë dhe ato gjyqësore për ndjekjen penale dhe gjykimin e çështjeve për veprën penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në tubim të paligjshëm", parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal.

6. Marrjen e menjëhershme të masave nga Prokuroria e Përgjithshme për përgatitjen e propozimeve konkrete drejtuar strukturave kompetente me qëllim ndryshimin e nenit 262 të Kodit Penal në përputhje me frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe praktikës së deritanishme të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Për të bërë të mundur monitorimin e protestave qytetare të zhvilluara në qytetin e Tiranës prej datës 09.12.2020 e në vijim u ngritën disa grupe pune të institucionit tonë, të cilët ndoqën nga afër jo vetëm protestat, por edhe situatën pasuese, gjatë shoqërimeve të shtetasve dhe trajtimin e tyre nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit.

Duke theksuar nevojën për ushtrimin në mënyrë paqësore të lirisë/drejtës së protestës e duke kërkuar vetëpërmbytje, konstatuam se numri i të shoqëruarve në datat 9 e 10 dhjetor 2020 ka qenë i lartë, në total 124 persona, nga të cilët 57 të mitur.

Të miturit janë lënë të lirë pas verifikimit të tyre dhe në momentin e inspektimit janë gjendur vetëm 2 të mitur të arrestuar, njëri prej tyre i moshës 16 vjeç dhe tjetri 17 vjeç. Rezulton se ky është një numër disa herë më i lartë se kapacitetet e shoqërimit dhe ndalimit në drejtorinë vendore dhe komisariatet e policisë së kryeqytetit, të cilat kanë mundësi akomodimi vetëm për 33 të shoqëruar dhe rreth 25 të arrestuar. Këto janë kapacitetet në gjendje normale, pa marrë në konsideratë masat shtesë të distancimit për shkak të emergjencës shëndetësore për shkak të virusit COVID-19.

Në momentin e inspektimit gjatë orëve të paradites së datës 11.12.2020⁵, ka pasur në total një numër prej 52 të arrestuarish. Dhomat e sigurisë ishin të pajisuara me dezinfektantë dhe në disa prej tyre kishte maska por jo në numër të mjaftueshëm për të gjithë të arrestuarit dhe të shoqëruarit.

Gjithashtu Avokati i Popullit ka konstatuar se përgjatë shoqërimeve në Polici të pjesëmarrësve në protestat e fundit, janë shoqëruar edhe disa të mitur nën moshën 14 vjeç dhe se procedurat e shoqërimit për ta kanë paraqitur disa problematika për të cilat është kryer një hetim administrativ dhe kanë dalë rekomandimet përkatëse drejtuar organeve kompetente⁶.

Avokati i Popullit ngre shqetësimin se problemet në lidhje me mbipopullimin apo procedurat përkatëse për shoqërimin e shtetasve në përgjithësi por edhe në kushtet e emergjencës shëndetësore në veçanti, pavarësisht rekomandimeve të adresuara në strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit në vijimësi, kanë mbetur të paadresuara dhe situata mbetet problematike inspektim pas inspektimi.

⁵ Të gjitha konstatimet e grupeve të ekspertëve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë inspektimeve/verifikimeve në orët e paradites së datës 11.12.2020 në ambientet e strukturave të Policisë së Shtetit, u përkasin procedurave të ndjekura me personat e shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar gjatë dhe pas protestave të datave 09.12.2020 dhe 10.12.2020.

⁶ Rekomandim i dërguar me shkresën nr.K5/I112-2 Prot. datë 11.01.2021, drejtuar Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

Në Komisarariat nr.1 situata paraqitet më komplekse për shkak të numrit masiv të të shoqëruarve që ishin sjellë në këtë organ. Në këtë Komisarariat ishin shoqëruar fillimisht 49 persona, nga të cilët 24 të rritur dhe 25 të mitur. Për këta të fundit, në kohën kur u realizua inspektimi u evidentua se nuk ishin përpiluar raportet e shoqërimit. Të miturve u ishin marrë gjenealogjet dhe ishte komunikuar me prindërit. Gjatë momentit të inspektimit në dhomat e shoqërimit dhe ndalimit në Komisarariat nr.1 ishin në total 16 persona, nga 6 persona që ishte kapaciteti. U konstatua se personave të arrestuar në këtë Komisarariat nuk iu ishin bërë vizitat mjekësore dhe nuk u ishin plotësuar kartelat mjekësore.

Vlerësojmë se mos kryerja e kontrollit mjekësor të personave të arrestuar në Komisarariat e Policisë nr. 1 Tiranë dhe mos plotësimi i kartelave shëndetësore vjen në kundërshtim me procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhër nr. 925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, respektivisht me pikat 7.1, 7.2 dhe 10.1.h ku parashikohet se:

“7.1 Para sistemimit/akomodimit në sistemin e dhomave të sigurisë, një punonjës policie i nivelit të parë drejtues i shërbimeve të rendit publik, specialisti i shërbimit të sallës së komandimit/ndihmës specialisti për informacionin dhe mjeku i policisë, kryejnë intervistimin, verifikimin dhe këqyrjen e jashtme të arrestuarit/ndaluarit nëse ka shenja të ushtrimit të dhunës, keqtrajtim, sëmundje të ndryshme që kanë nevojë për ndihmë mjekësore apo ankesa të tjera të kësaj natyre.

7.2 Detyrimisht në këtë moment sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se 12 orë pas ndalimit/arrestimit kryhet kontrolli/vizita mjekësore nga mjeku apo ndihmësmjeku i drejtorisë/komisariatit policisë”.

10.1 Për çdo person të arrestuar/ndaluar që mbahet në dhomat e sigurisë, çelet fashikulli i cili merr për numër rendor që ka emri i tij në regjistrin e personave të arrestuar/ndaluar, i cili gjatë periudhës që personi mbahet në këto ambiente duhet të plotësohet me këto dokumente:

- a) Procesverbali i arrestimit në flagrancë ose urdhri për ndalimin.*
- b) Kopje të urdhrat të prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal.*
- c) Vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.*
- d) Procesverbali për ekzekutimin e vendimit të gjykatës për dënimin e tij me burgim së bashku me kopjen e këtij vendimi, (për të dënuarit në mungesë me burgim).*
- e) Procesverbali i kontrollit fizik/personal.*
- f) Formularin e identifikimit me foto dhe gjurmët e gishtërinjve.*
- g) Certifikata personale e gjendjes civile, ose një nga dokumentet e identifikimit (kartë të identitetit, pasaportë, etj).*
- h) Kartela mjekësore me shënimet përkatëse të mjekut.*
- i) Procesverbali për dorëzimin e sendeve personale të arrestuarit/ndaluarit kur lihet i lirë apo transferohet në IEVP, që u jepen familjarëve apo të afërmeve të personit, si dhe organit të prokurorisë kur këto të fundit kërkojnë një gjë të tillë.*

Në Komisarlatin e Policisë nr. 2 pas verifikimeve, u konstatua se në datat 9 dhe 10 dhjetor 2020 ishin shoqëruar 38 persona, 10 prej të cilëve të mitur nën moshën 18 vjeç.

Ndërsa, në Komisarlatin nr. 3, ishin shoqëruar 13 të mitur të cilët ishin lënë më pas të lirë, pas kryerjes së procedurave ligjore përkatëse. Në momentin e vizitës së përfaqësuesve të Avokatit të Popullit, në këtë Komisarlat mbaheshin 5 persona të arrestuar, nga të cilët njëri paraqiste probleme shëndetësore të karakterit mendor. Këta persona mbaheshin në kushte të papërshtatshme për ruajtjen e shëndetit të tyre, pasi kapaciteti në këtë Komisarlat ishte vetëm për 3 persona.

Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në datën 10.12.2020, ishin shoqëruar 17 shtetas, 9 prej të cilëve nën moshën 18 vjeç. Këta të fundit pas kryerjes së procedurave ligjore përkatëse janë lënë të lirë një orë pas shoqërimit.

Të gjithë të arrestuarit në të gjitha komisarlatet u intervistuan për veprimet e kryera në protestë. Disa prej tyre deklaruan se kanë marrë pjesë në protestë, por nuk kanë kryer veprime të dhunshme. Disa të tjerë pretenduan se kanë qenë kalimtarë të rastit dhe nuk kanë marrë pjesë në protestë. Dy të miturit e arrestuar, akomoduar në ambientet e Komisarlatit të Policisë nr. 2 Tiranë, të pyetur nëse kanë qenë të pranishëm avokati apo psikologu gjatë marrjes në pyetje, u përgjigjen se janë pyetur vetëm nga punonjësi i policisë që u ka bërë presion të pranonin se kishin kryer veprime të dhunshme gjatë protestës.

Gjithashtu ata pretenduan se avokati ka ardhur në një moment të dytë dhe ka firmosur dokumentet që mbanin me vete (procesverbal të arrestimit, procesverbal të kontrollit personal dhe letrën e të drejtave të të miturit nën hetim).

Për sa i përket rastit të punonjësit të medias Xhoi Malësia, shpjegimi verbal nga autoritetet policore ishte se ai nuk është trajtuar si i shoqëruar dhe nuk është mbajtur në dhomat e shoqërimit⁷.

Gjithashtu, përfaqësues të Avokatit të Popullit kanë monitoruar edhe Qendrën Kombëtare të Shërbimit Mjekësor për të marrë informacion mbi numrin e personave që kanë marrë shërbim mjekësor në urgjencë përgjatë dy ditëve të protestave të datat 09.12.2020 dhe 10.12.2020.

Nga verifikimi i dokumentacionit në këtë institucion rezultoi se të gjithë personat e paraqitur në urgjencë në të dyja ditët e protestës kanë marrë shërbimin dhe janë larguar.

Më konkretisht, ditën e parë të protestës në datën 09.12.2020 janë paraqitur për të marrë ndihmë mjekësore 14 efektivë të Policisë së Shtetit dhe 2 protestues, ndërsa ditën e dytë datë 10.12.2020, 5 efektivë të Policisë së Shtetit dhe 2 protestues. Punonjësit e Policisë paraqisnin

⁷ Për më tepër, të gjitha shkeljet e gjetura për të drejtën e gazetarëve/medias për të ushtruar profesionin e tyre, janë objekt i një hetimi të veçantë të Avokatit të Popullit, në përfundim të të cilit do të dalin rekomandimet përkatëse.

kryesisht dëmtime të shkaktuara nga hedhja e gurëve dhe sendeve të forta. Një prej tyre që kishte pësuar dëmtime të syrit paraqiste gjendje edhe më serioze.

Nga verifikimi i regjistrave mjekësorë, rezultoi se të gjithë personat e mësipërm kanë marrë mjekimin e nevojshëm dhe janë larguar nga ambientet spitalore, me përjashtim të një punonjësi të policisë që kishte marrë dëmtime në këmbë.

Në vijim të protestave të zhvilluara në datat 11, 12 dhe 13 dhjetor 2020, Avokati i Popullit ka vijuar punën në terren duke i monitoruar nga afër ato, si edhe situatën pas përfundimit të protestave, duke kryer inspektime dhe vizita në komisariatet e Policisë Vendore Tiranë.

Nga të dhënat paraprake të inspektimit, si dhe të intervistave dhe ankesave të administruara nga përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit rezultoi se në datën 11.12.2020 janë shoqëruar gjithsej 133 shtetas, nga të cilët 36 të mitur. Të miturit janë lënë të lirë pas verifikimit të tyre brenda një kohe relativisht të shkurtër.

Konkretisht:

- Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në datën 11.12.2020 janë shoqëruar 26 shtetas, nga të cilët 7 të mitur. Arrestimi në gjendje flagrante ishte aplikuar ndaj 7 shtetasve, por asnjë prej tyre nuk ishte i mitur. Në total në momentin e kryerjes së inspektimit, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë gjendeshin 33 shtetas të arrestuar, një numër ky i lartë krahasimisht me kapacitetet përkatëse, veçanërisht në kushtet e nevojës për të garantuar distancimin për shkak të emergjencës shëndetësore COVID-19.

Punonjësit tanë u informuan se shumë nga të arrestuarit e një dite më parë (të datës 10.12.2020) që gjendeshin në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Komisarariat nr. 2, ishin transferuar në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe Komisarariat e Policisë Kavajë, për shkak të mungesës së kapaciteteve në ambientet e strukturave të Policisë Vendore Tiranë.

- Në Komisarariat e Policisë nr. 1, në datën 11.12.2020, janë shoqëruar 27 shtetas, ndër të cilët nuk ka pasur persona të mitur. Nga personat e shoqëruar, 7 prej tyre ishin arrestuar në kushtet e flagrancës.

- Në Komisarariat e Policisë nr. 2, në datën 11.12.2020 janë shoqëruar 54 shtetas, nga të cilët 24 të mitur të cilët pas verifikimeve të nevojshme ishin lënë të lirë më pas. Nga personat e shoqëruar, 8 prej tyre ishin arrestuar në kushtet e flagrancës, nga të cilët 7 persona gjendeshin në ambientet e Komisarariatit nr. 2.

- Në Komisarariat e Policisë nr. 3, në datën 11.12.2020, janë shoqëruar 22 persona, nga të cilët 5 të mitur të cilët pas verifikimeve ishin lënë të lirë më pas. Nga personat e shoqëruar, 3 prej tyre ishin arrestuar në kushtet e flagrancës.

- Në Komisarariat e Policisë nr. 6, në datën 11.12.2020 janë shoqëruar 4 shtetas, ndër të cilët nuk ka pasur persona të mitur. Nga personat e shoqëruar, 3 prej tyre ishin arrestuar në kushtet

e flagrancës dhe ishin transferuar në Komisarlatin e Policisë nr. 3, ndërsa 1 person ishte lënë i lirë. Në momentin e kryerjes së verifikimeve nuk gjendej asnjë person i shoqëruar në këto ambiente.

Ndër personat e arrestuar, dy prej tyre kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në protestë, por nuk kanë kryer veprime të dhunshme, ndërsa disa të tjerë pretenduan se kanë qenë kalimtarë të rastit dhe nuk kanë marrë pjesë në protestë.

Nga personat e intervistuar pati pretendime për veprime të dhunshme nga ana e policisë, si edhe ankesa formale të paraqitura për të mundësuar më tej hetimin e institucionit tonë. Dy prej personave të intervistuar kanë pretenduar se ndaj tyre është ushtruar dhunë (janë qëlluar me shpulla dhe grushta) në furgonin e policisë nga një punonjës i veshur civil si dhe njërit prej shtetasve një punonjës tjetër i veshur civil i ka marrë dhe thyer celularin me të cilin po filmonte protestën. Gjithashtu, një prej personave të intervistuar ka pretenduar se dy punonjësit e policisë që e kanë marrë në pyetje e kanë goditur me shuplakë dhe grusht në fytyrë kur ai nuk ka pranuar të nënshkruajë proceverbalin e marrjes në pyetje.⁸

Ndërsa, për protestën e datës 12.12.2020 janë shoqëruar gjithsej 49 shtetas, nga të cilët 24 të mitur. Më konkretisht, shpërndarja e shtetasve në ambientet e strukturave të policisë, ka qenë si më poshtë:

Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, janë shoqëruar 6 persona, nga të cilët 1 prej tyre ishte i mitur. Në veprimet procedurale të kryera me shtetasin e mitur, rezultoi se nuk janë respektuar parashikimet dhe standardet e legjislacionit lidhur me praninë e përfaqësuesit ligjor e psikologut, si edhe vendit të marrjes në pyetje. I mituri gjatë intervistimit pohoi për përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit se ka qenë në protestë si kalimtar dhe më pas ishte shoqëruar nga policia, por ndaj tij nuk ishte ushtruar dhunë.

Në Komisarlatin nr. 1 ishin shoqëruar gjithsej 7 persona nga të cilët 3 ishin të mitur. Të gjithë personat e shoqëruar ishin lënë të lirë pas kryerjes së procedurave përkatëse.

Në Komisarlatin nr. 2 ishin shoqëruar gjithsej 25 persona, nga të cilët 16 ishin të mitur. Të gjithë personat e shoqëruar ishin lënë të lirë pas kryerjes së procedurave.

Në Komisarlatin nr. 3 ishin shoqëruar gjithsej 8 persona, nga të cilët 4 ishin të mitur. Një prej personave të mitur, ka deklaruar për përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit se ndaj tij është ushtruar dhunë fizike në momentin e kapjes, nga punonjësit civilë.

Në Komisarlatin nr. 4 ishin gjithsej 3 të shoqëruar, nga të cilët një i mitur.

⁸ Ankesat dhe rastet me iniciativë për dhunë fizike apo/dhe psikologjike të ushtruar nga punonjësit e Policisë së Shtetit ndaj shtetasve të shoqëruar dhe arrestuar/ndaluar gjatë dhe pas protestave, gjatë shoqërimit të tyre në automjetet e Policisë së Shtetit si dhe në zyrat apo ambientet përkatëse të Policisë së Shtetit janë objekt i një hetimi tjetër administrativ të ndjekur nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Në Komisarjatin nr. 5 nuk kishte persona të shoqëruar. Aty gjendej i arrestuar vetëm një person i transferuar nga Komisarjati nr. 3.

Në komisarjatin nr. 6 nuk kishte persona të shoqëruar.

Lidhur me protestën e datës 13.12.2020, nga të dhënat paraprake të inspektimit, si dhe të intervistave e ankesave të administruara nga përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit rezultojnë si më poshtë:

Janë shoqëruar gjithsej 51 shtetas, nga të cilët 9 të mitur. Të miturit janë lënë të lirë pas verifikimit të tyre, me përjashtim të një rasti, i cili dispononte lëndë piroteknike. Ndër personat e shoqëruar është konstatuar se janë shoqëruar edhe tre shtetas të gjinisë femër.

Konkretisht:

- Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, janë shoqëruar 2 persona, nga të cilët nuk kishte pasur persona në moshë të mitur.
- Në Komisarjatin e Policisë nr. 1, janë shoqëruar gjithsej 16 persona, nga të cilët 1 në moshë të mitur dhe 2 të gjinisë femër.
- Në Komisarjatin e Policisë nr. 2, janë shoqëruar gjithsej 10 persona, nga të cilët 3 në moshë të mitur dhe 1 e gjinisë femër.
- Në Komisarjatin e Policisë nr. 3, janë shoqëruar gjithsej 18 persona, nga të cilët 6 në moshë të mitur.
- Në Komisarjatin e Policisë nr. 4, janë shoqëruar gjithsej 4 persona, nga të cilët nuk ka pasur persona në moshë të mitur.
- Në Komisarjatet e Policisë nr. 5 dhe nr. 6 nuk ka pasur persona të shoqëruar.

Në intervistat e zhvilluara me përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit, disa prej të shoqëruarve deklaruan se kanë marrë pjesë në protestë, por nuk kanë kryer veprime të dhunshme ndërsa disa të tjerë pretenduan se kanë qenë kalimtarë të rastit dhe nuk kanë marrë pjesë në protestë.

Gjithashtu, përfaqësues të Avokatit të Popullit kanë monitoruar në datat 12 e 13 dhjetor 2020 edhe Qendrën Kombëtare të Shërbimit Mjekësor për të marrë informacion mbi numrin e personave që kanë marrë shërbim mjekësor në urgjencë. Nga informacioni i mbledhur ka rezultuar se në Spitalin e Traumës kanë marrë shërbim mjekësor 2 efektivë të Policisë me dëmtime respektivisht në krah dhe në këmbë, dhe një protestues, të cilët pasi janë mjekuar kanë lënë ambientet e spitalit.

Përveç sa më sipër nga grupet e punës së institucionit tonë u konstatuan edhe disa problematika të tjera që lidhen me trajtimin e personave të shoqëruar dhe arrestuar/ndaluar dhe konkretisht:

- Në disa Komisariate si nr. 1 dhe 3 u konstatua se të miturit e shoqëruar nuk ishin regjistruar në regjistrin e evidentimit të personave të shoqëruar në organin e policisë, por në një regjistër të veçantë. Ky veprim nuk është korrekt dhe në përputhje me aktet normative në fuqi që rregullojnë këtë veprimtari të Policisë së Shtetit. Konkretisht në Procedurën Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938, datë 24.07.2019, në kapitullin VIII parashikohet se:

“Akti/veprimi i shoqërimit, detyrimisht, evidencohet e dokumentohet në sistem elektronik, në regjistra, në formularë dhe procesverbale.

Procedurat e evidentimit të veprimeve që janë kryer me të shoqëruarin kryhet nga punonjësi i policisë që ka punuar dhe sqaruar çështjen, ndërsa hedhja e të dhënave në regjistër dhe në sistemin elektronik të të dhënave kryhen nga punonjësi i policisë të shërbimit të informacionit në njësinë policore.

Mos zbatimi i kësaj kërkesë nga personat përgjegjës për dokumentimin e aktit të shoqërimit, përbën shkelje të rëndë disiplinore.

1. Evidentimi i veprimeve dhe të dhënave, që kryhen me personat e shoqëruar bëhet në rrugë:

a. Manuale,

b. Elektronike.

a. Dokumentimi i të dhënave në rrugë manuale kryhet në:

a.1 - Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar (lidhja 1),

a.2- Formularin e Raportit të Shoqërimit (lidhja 2),

a.3 - Proces verbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar (lidhja 3).

a.1.1- Hedhja e të dhënave në Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për personat e Shoqëruar kryhet nga punonjësi i shërbimit të funksionit: ndihmës specialist për informacionin të strukturave të rendit publik të njësive policore.

Këto të dhëna hidhen menjëherë dhe pa vonesë në regjistër pas mbërritjes/shoqërimit të personit nga punonjësi i policisë dhe akomodimit të tij në ambientet e shoqërimit”.

Sikurse rezulton në mënyrë të qartë nga përmbajtja e kësaj procedure, evidentimi e veprimeve dhe i të dhënave që kryhen në mënyrë manuale me personat e shoqëruar, qofshin ata edhe të mitur, bëhet në Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar (lidhja 1) dhe jo në regjistra të tjerë sikurse është vepruar në fakt. Regjistrimi në këtë dokument është me rëndësi sepse pikërisht tek ky regjistër, janë përcaktuar rubrikat e gjeneraliteve, shkakut ligjor të shoqërimit, emrit të punonjësit të policisë që ka bërë shoqërimin dhe atij që ka kryer veprime me të shoqëruarin, orës së shoqërimit dhe lënies së lirë të personit të shoqëruar. Përveç sa më lart, janë përcaktuar edhe disa rubrika të tjera shumë të rëndësishme që lidhen me trajtimin dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, sikurse janë njoftimi i familjarëve, që për të miturit përbën detyrim, ora e njoftimit, numri i telefonit, si dhe pretendimet që ata mund të kenë në lidhje me veprimet e kryera me ta. Parashikimi i këtyre rubrikave përcakton detyrimin e punonjësit të policisë t’i plotësojë ato, ndërkohë kjo krijon edhe mundësinë e verifikimit të

respektimit të të drejtave të të shoqëruarëve nga organet e kontrollit të brendshëm apo të jashtëm.

Ndërsa mos plotësimi i Formularit të Raportit të Shoqërimit në disa raste ndaj personave të shoqëruar të mitur të cilët i përmendëm më sipër, vjen në kundërshtim me pikën a.2.1 të kapitullit VIII të kësaj procedure ku parashikohet se:

“Formulari i Raportit të Shoqërimit plotësohet nga punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin e personit, menjëherë pas shoqërimit të personit në ambientet e policisë/ambientet e shoqërimit”.

Një shqetësim i evidentuar gjatë ditëve të inspektimeve, është ai i ngritur nga një numër jo i vogël prindërisht të të arrestuarve që lidhej me mosnjohimin për transferimin e fëmijëve të tyre nga ambientet e Policisë Vendore Tiranë në organet e Policisë në qytete të tjera. Sipas këtyre shtetasve, ata ishin gjendur përballë situatave të papritura në momentet kur ishin paraqitur në organet e Policisë Tiranë për t’ju sjellë veshmbathje dhe ushqime fëmijëve të tyre të arrestuar, por nga punonjësit e zyrës së informacionit janë njoftuar se ata ishin transferuar në organet e tjera të Policisë jashtë qytetit të Tiranës.

Sjellim në vëmendje se, referuar procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin nr. 925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, njoftimi i familjarëve të të arrestuarve në rastet e transferimit të këtyre të fundit është një e drejtë e garantuar e të shoqëruarëve, arresturve/ndaluarëve dhe njëkohësisht detyrim për organet e policisë. Në kapitullin VI, pika 1.3, të kësaj procedure parashikohet se:

“Të njoftojë një pjesëtar të familjes, një të afërm apo persona të tjerë të zgjedhur prej tyre duke bërë telefonatë në prezencë të punonjësve të policisë për vendndodhjen, situatën në të cilën është, në rastet e transferimeve nga një komisarjat policie në tjetrin, kur transferohet në IEVP, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë refuzohet nga të ndaluarit apo arrestuarit e moshës madhore”.

Gjatë monitorimit të protestave të zhvilluara nga data 9 deri më 13 dhjetor 2020 kemi konstatuar se një numër pjesëmarrësish kryesisht të mitur, kanë kryer veprime të dhunshme. Ata goditën me sende të forta punonjësit e Policisë të vendosur me shërbim, godinat qeveritare dhe objekte të tjera pronë publike apo private duke cenuar rendin dhe sigurinë publike, dëmtuar shëndetin e disa punonjësve të Policisë dhe shkaktuar pasoja të konsiderueshme financiare.

Theksojmë se, Avokati i Popullit e ka shprehur në vijimësi qëndrimin e tij të palëkundur në lidhje me garantimin e ushtrimit të lirisë kushtetuese të tubimeve paqësore edhe gjatë pandemisë, por nga ana tjetër ka kërkuar vetëpërbajtje e ka bërë thirrje kundër çdo akti dhune si ndaj punonjësve të Policisë, ashtu edhe ndaj institucioneve dhe pronës publike e private.

E drejta e përdorimit të forcës nga punonjësit e Policisë së Shtetit parashikohet në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, nenet 101,102,103 dhe 133. Në këto dispozita parashikohen masat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike sipas të cilave, kur sjellja e një personi cenon rendin dhe sigurinë publike punonjësi i policisë, në zbatim të përgjegjësisë së tij dhe në përputhje me ligjin, merr masa për shmangien e rrezikut për shtetasin dhe veten si dhe vlerëson nëse është e nevojshme marrja e masave shtesë ose dhënia e ndihmës dhe njofton menjëherë autoritetet përgjegjëse administrative. Po ashtu, në këto dispozita përcaktohet se “masa për të shmangur rrezikun duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë, të drejtat dhe interesat që vihen në rrezik dhe/ose cenohen, si dhe nuk duhet të përbëjë kapërcim të kufijve të nevojës për situatën e paraqitur. Vetëm nëse kjo masë është e paefektshme, atëherë mund të zgjidhet një masë tjetër proporcionale me ndikim më të madh. Zbatimi i mëtejshëm i çdo mase të ndërmarrë ndërpritet menjëherë kur shkaku i saj nuk ekziston më. Ndërsa, zbatimi i masës së menjëhershme merret vetëm nëse duhet mënjanuar një rrezik real dhe i çastit për rendin dhe sigurinë publike, i cili nuk mund të shmanget me anë të mjeteve të tjera duke njoftuar menjëherë personin ndaj të cilit ajo ndërmerret”.

Referuar nenit 133 të ligjit të sipërpërmendur sipas të cilit:

1. Punonjësi i policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura.
2. Punonjësi i policisë përdor forcën në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
3. Punonjësi i policisë përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara, që, ndër të tjera, përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, mjete me lëndë paralizuese, mjete me goditje elektrike, qen policie dhe armë zjarri.
4. Të dëmtuarit i jepet ndihmë, ku përfshihet edhe ajo mjekësore, pas përdorimit të forcës, në rast se kjo është e nevojshme dhe e mundur.
5. Punonjësi i policisë duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj. Ky paralajmërim mund të mos kryhet nëse rrethanat nuk e lejojnë, veçanërisht kur përdorimi i menjëhershëm i forcës është i nevojshëm për të parandaluar një rrezik real dhe të çastit.
6. Grupe personash paralajmërohen sa më shpejt të jetë e mundur se do të përdoret forcë ose forma e forcës së përdorur do të ndryshohet, në mënyrë që pjesëmarrësit të lejohen të largohen.

Ndërkohë përdorimi i forcës parashikohet edhe në VKM nr. 750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, përkatësisht nenet 110 dhe 211. Në nenin 110 të kësaj Rregulloreje parashikohet se:

1. Punonjësi i Policisë përdor forcën vetëm kur është në mënyrë të arsyeshme e nevojshme dhe vetëm në masën që kërkohet për të arritur një synim të ligjshëm.
2. Punonjësi i Policisë, në çdo rast e përdor forcën pa cenuar thelbin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe përdor gjithmonë mjete të përshtatshme në proporcion me rrezikun dhe qëllimet që synohen të arrihen.
3. Punonjësi i Policisë është përgjegjës individualisht për ushtrimin e forcës dhe jep llogari para ligjit.

Ndërsa në nenin 211 të saj parashikohet se:

Punonjësi është përgjegjës për përdorim të paligjshëm dhe të paarsyeshëm të forcës, nëse:

- 1. përdor forcën në intensitet dhe kohë, mbi masën që është e domosdoshme për të arritur objektivin legjitim dhe të ligjshëm të Policisë;*
- 2. përdor forcën, e cila nuk është proporcionale me shkallën e kërcënimit dhe nuk është e balancuar me nevojën për të zvogëluar shkaktimin e viktimave civile, dëmet e pasurisë, si dhe ambientin natyror;*
- 3. përdor mjetet për përdorimin e forcës në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore të Policisë.*

Në këtë akt nënligjor parashikohen edhe standardet e normat e sjelljes së punonjësve të policisë⁹. Sipas të cilave, *punonjësi i policisë vepron i udhëhequr nga vetëkontrolli dhe toleranca, duke trajtuar publikun dhe kolegët me respekt dhe mirësjellje. Ai ushtron përgjegjësitë në proporcion me situatën, në përputhje me ligjin dhe në respekt të të drejtave të njeriut dhe të sigurohet që sjellja dhe fjalori i përdorur nga ana e tij, të mos perceptohen si abuzive, ofenduese, ngacmuese, tallëse apo viktimizuese duke respektuar dinjitetin e gjithsecilit.*

Nga media të ndryshme vizive u bënë publike disa pamje filmike ku dukeshin qartë disa punonjës të Policisë duke goditur me shkop gome apo grushta shtetasit e kapur në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” ndërkohë që ata nuk po bënë ndonjë rezistencë të madhe apo kundërveprim me rrezik për jetën e punonjësve të Policisë. Duke iu referuar parimit të proporcionalitetit kur përdoret forca, rezultoi se ka patur kapërcim të kufijve të nevojës për situatën e paraqitur dhe tejkalim të përdorimit të forcës¹⁰.

Një problematikë e konstatuar nga inspektimet e bëra nga punonjësit e institucionit tonë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe në komisariatet në varësi të saj gjatë ditëve të protestave lidhet me ankesat nga disa të shoqëruar dhe të arrestuar të cilët pretenduan se nuk kishin marrë takim me avokatët mbrojtës. Ndërkohë, nga ana e dy punonjësve të institucionit tonë që ndodheshin të pranishëm në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr. 1 Tiranë, u konstatua edhe një rast kur avokati A.G. nuk u lejua nga punonjësit e policisë që të merrte takim me klientin A.B. i cili ishte arrestuar për shkak të pjesëmarrjes së tij në protestë dhe ndodhej në ambientin e sigurisë të këtij komisariati. Justifikimi i këtyre punonjësve të policisë për të mos lejuar takimin e avokatit me të arrestuarin ishte se ai nuk ishte i pajisur me prokurë të posaçme si mbrojtës i shtetasit A.B.. Pretendimi i punonjësve të policisë ishte i pabazuar në ligj dhe se prokura nëse deklaroi i arrestuari/ndaluari nuk nevojitet. Ngjarja çoi në pretendimin se i arrestuari ishte në gjendje të keqe shëndetësore e i dhunuar dhe prandaj nuk lejohej avokati.

⁹ Nenet 115 dhe 117 të VKM nr.750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”.

¹⁰ Gjetjet përkatëse mbi zbatimin e parimit ligjor të proporcionalitetit kur përdoret forcë fizike për të kontrolluar sjelljen e protestuesve kanë qenë objekt i Rekomandimit të dërguar me shkresën nr.K2/I4-2 Prot. datë 11.06.2021, drejtuar Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat si dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

U desh ndërhyrja e Avokatit të Popullit dhe të bëhej një deklaratë zyrtare pasi gjendja u agravua nga njoftimet e bëra në rrjetet sociale.

Një tjetër shqetësim i ngritur nga disa prej të arrestuarve lidhej me faktin se ndonëse ata ishin pyetur pa praninë e avokatit të caktuar kryesisht, këta të fundit kishin firmosur në dokumente sikur kishin qenë të pranishëm.

Jo vetëm nga këto raste konkrete, por nisur edhe nga ankesa të parashtruara edhe më parë nga disa avokatë se nuk lejoheshin të merrnin takim me klientët e tyre në organet e policisë para se ata të merreshin në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore, vlerësojmë se kjo është një çështje shumë serioze sepse lidhet me shkelje të të drejtave themelore kushtetuese e ligjore të shtetasve.

Për këtë arsye, ju sjellim në vëmendje se rivendosja juridikisht e institutit të mbrojtjes, avokatisë¹¹ në fillim të viteve '90, është pjesë rëndësishme e procesit të demokratizimit të vendit tonë. Ajo përbën një nga arritjet e sistemit tonë demokratik, në fushën e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të njohura dhe sanksionuara nga konventat ndërkombëtare dhe veçanërisht nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948, si dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, miratuar nga vendet e Këshillit të Europës, më 4 nëntor 1950, të cilat janë njohur dhe ratifikuar nga vendi ynë.

Aktualisht, në nenin 4 të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” parashikohet si më poshtë vijon:

“Avokati ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet:

- a) këshillimit ligjor të personave fizikë dhe juridikë;*
- b) përfaqësimit në procesin penal, civil, administrativ, ose të ndonjë natyre tjetër që mund të mos përfshihet në këto tri kategori, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda ose jashtë vendit, pranë gjykatave ndërkombëtare ose çdo organizmi tjetër, pranë të cilit Republika e Shqipërisë ka aderuar, si dhe përfaqësimit në procedurat e ndërmjetësimit ose të arbitrazhit;*
- c) hartimit të akteve juridike dhe çdo akti tjetër, sipas kërkesave të personave fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;*
- ç) veprimeve të tjera të parashikuara në legjislacionin shqiptar ose në legjislacionin e huaj, kur veprimtaria kryhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.”*

Në nenin 6/2 të po këtij ligji, parashikohet se:

“Profesioni i avokatit mund të ushtrohet përpara çdo gjykate, prokurorie, gjykate arbitrazhi, apo organi publik, në mënyrë individuale, ose në bashkëpunim me avokatë të tjerë të organizuar në studio avokatie.”

Ndërsa, në nenin 11 të tij “Të drejtat e avokatit” përcaktohet se:

¹¹ Ligji nr. 7541, datë 18.12.1991 “Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë”.

“Avokati, në ushtrim të profesionit të tij, ka të drejtë:

a) të ofrojë shërbimin e avokatisë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në mënyrë të lirë, të pavarur dhe autonome, pa kufizime, kundrejt çdo klienti, vendas ose të huaj, që ushtron veprimtarinë brenda ose jashtë vendit;

b) të kërkojë të dhëna, shpjegime ose dokumente që kanë lidhje me çështjen ose klientët që përfaqësohen ose mbrohen prej tij, nga çdo institucion i administratës publike, gjykatat, prokuroritë, gjykatat e arbitrazhit, noterët, përmbaruesit, organet e Policisë së Shtetit, apo nga çdo ent publik ose subjekt privat, në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

c) të takojë vetëm për vetëm klientin, përpara marrjes në pyetje për herë të parë dhe në çdo fazë të procedimit penal, si dhe të njihet me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose ndalimit të klientit, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale;

ç) të asistojë në proces, të pyesë klientin, dëshmitarët dhe ekspertët, të njihet në përfundim të hetimit me të gjitha aktet dhe dokumentet që lidhen me çështjen dhe t'i nënshkruajë ato kur klienti e autorizon dhe pranon një gjë të tillë, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, në funksion të realizimit të një mbrojtjeje efektive të klientit të tij të pandehur në një proces penal;

d) të kërkojë nga organet kompetente respektimin e të drejtave dhe garancive në çdo fazë të procedimit penal, si dhe gjatë ekzekutimit të vendimit penal të formës së prerë, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të pranuar nga Republika e Shqipërisë;

dh) të ushtrojë profesionin në mënyrë të pavarur dhe autonome.”

Është me shumë rëndësi që të ndalemi në ofrimin e ndihmës juridike nga avokati me praninë e tij si mbrojtës, në rastet e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të personave. Mos lejimi i avokatit për të marrë takim me personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar dhe për të qenë i pranishëm gjatë kryerjes së veprimeve procedurale të arrestimit/ndalimit të një personi nga oficerët e policisë gjyqësore apo edhe prokurori, kur ai kërkohet nga vetë personi i shoqëruar, arrestuar/ndaluar, apo edhe nga familjarët e një personi të mitur, përbën një shkelje të rëndë të një të drejte themelore të njeriut.

Kjo e drejtë është e garantuar nga aktet si më poshtë:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht nga nenet 28, pika 1, dhe 31/ç që sanksionojnë se:

Neni 28, pika 1

“Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij”.

Neni 31/ç

“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;”

2. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila në nenin 6, pika 3/c parashikon se:

“Çdo i akuzuar ka të drejtë që të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij...”

3. Ligjin nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, nenin 6/2 dhe nenin 11/a, c, ç, d të cilët i cituam më sipër.

Në të njëjtën kohë ky qëndrim përbën edhe shkelje të nenit 12/1/c të tij “Të drejtat dhe detyrimet e organeve të tjera”, ku parashikohet se:

“1. Gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit, çdo institucion i administratës publike, gjykatat, prokuroritë, gjykatat e arbitrazhit, noterët, përmbaruesit, organet e Policisë së Shtetit, apo çdo ent tjetër publik ose subjekt privat, janë të detyruara të plotësojnë kërkesat e ligjshme të avokatit në lidhje me:

c) garantimin e takimit të avokatit vetëm për vetëm me klientin, përpara marrjes në pyetje për herë të parë të tij dhe në çdo fazë të procedimit penal, pa autorizim të posaçëm të organeve proceduese dhe me miratim të klientit ose të familjarëve të tij, si dhe vënien në dispozicion të akteve, provave dhe arsyeve të arrestimit ose ndalimit të klientit, në përputhje rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale;”

4. Kodin e Procedurës Penale dhe konkretisht të nenit 255 të tij, ku janë përcaktuar detyrat e policisë gjyqësore në rastet e arrestimit ose ndalimit të personit. Sipas pikës 1 të këtij neni, *oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që kanë kryer një arrestim ose ndalim ose kanë marrë në dorëzim të arrestuarin, njoftojnë menjëherë prokurorinë e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi. Ata i bëjnë të ditur të arrestuarit ose të ndaluarit se nuk ka asnjë detyrim të bëjë deklarata dhe në qoftë se do të flasë, çfarëdo që ai thotë, mund të përdoret ndaj tij në gjykim. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore i bëjnë të ditur të ndaluarit ose të arrestuarit edhe të drejtën që ai ka për të zgjedhur mbrojtës dhe njoftojnë menjëherë mbrojtësin e zgjedhur ose, kur është rasti, atë të caktuar nga prokurori....”*

Sqarojmë se në bazë të K.Pr.Penale nenit 32, pikat 1/a dhe 2/a, si dhe të nenit 18 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, çdo punonjës i policisë gëzon atributet e Policisë Gjyqësore, oficerë dhe agjentë të policisë gjyqësore në përputhje me legjislacionin procedural penal dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

5. Ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, respektivisht nenin 109/3 të tij, ku parashikohet se:

“3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimit. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin”.

Nenin 112/2/dh të këtij ligji “Të dhënat në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit” parashikohet se:

“Për të regjistruar nga ana administrative të dhënat e personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, policia kryen këto veprime:

2. Në rast arrestimi apo ndalimi, policia evidenton për çdo person të dhënat për:

dh) hollësi për mënyrën e kryerjes së veprës penale, për të cilën është arrestuar apo ndaluar, të cilat merren në prani të mbrojtësit në rast se personi nuk e refuzon atë;”

6. Procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin nr. 925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në kapitullin VI, “Të drejtat dhe detyrimet e të ndaluarve/arresturve”, respektivisht pikat 1.2 dhe 1.4 parashikohet se:

“1.2 Të mbrohet e përfaqësohet me avokat, duke e zgjedhur atë vetë por jo më shumë se dy mbrojtës, ose të caktuar nga prokurori sipas përcaktimeve të nenit 255 të K.Pr.Penale. Takimet dhe konsultimet e personit të arrestuar/ndaluar me avokatin mbrojtës zhvillohen në mënyrë private dhe pa praninë e asnjë personi tjetër.

“1.4 Të marrë takim në çdo kohë me avokatin mbrojtës, kujdestarin ligjor, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, sa herë që kërkohet nga këta të fundit”.

Ndërsa në kapitullin e VII, pika 5.1.b parashikohet se:

“Nxjerrja e të ndaluarit e arrestuarit nga dhoma e qëndrimit për në dhomën e intervistimit/marrjes në pyetje bëhet kur:

b) Kur kërkohet të takohet nga avokati mbrojtës i zgjedhur nga i arrestuari/ndaluari apo i caktuar nga prokurori. Avokati mbrojtës ka të drejtë të marrë takim me klientin e tij në çdo kohë dhe sa herë që e sheh të arsyeshme”.

Nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore të cituara më sipër, rezulton në mënyrë shumë të qartë **detyrimi që kanë punonjësit e policisë gjyqësore për të vënë në dijeni të shoqëruarin, të arrestuarin ose të ndaluarin për të mos bërë ndonjë deklaratë, si dhe për t’ia bërë të njohur të drejtën që ai ka për të komunikuar dhe për t’u mbrojtur nga avokati. Gjithashtu në bazë të këtyre dispozitave, në qoftëse personi kërkon të mbrohet nga avokati, punonjësit e policisë gjyqësore kanë detyrimin që të njoftojnë menjëherë avokatin, mbrojtësin e tij, dhe t’i japin mundësinë për realizimin e kësaj të drejte.**

Në analizën tonë, të gjitha këto parashikime ligjore të trajtuara më lart, përcaktojnë në mënyrë shumë të qartë detyrimin se:

a) personit të shoqëruar, arrestuar ose të ndaluar, të mos i merret asnjë deklaratë nëse ai nuk dëshiron. Por nga disa ankesa të trajtuara deri më tani nga institucioni i Avokatit të Popullit, rezulton se nga punonjësit e policisë ndaj personave të arrestuar/ndaluar nuk zbatohet gjithmonë ky detyrim ligjor. Ata jo vetëm nuk i bëjnë të qartë personit këtë të drejtë, por përkundrazi i marrin deklaratime jashtë dëshirës dhe vullnetit të tij dhe me mjete jot ë ligjshme. Nëpërmjet dhunës psikologjike i kërkojnë të shoqëruarit, arrestuarit/ndaluarit të pranojë veprën penale për të cilën ata e akuzojnë, provat e saj, bashkëpunëtorët, vepra penale të tjera të kryera prej tij ose nga persona të tjerë, etj.

b) nëse avokati i zgjedhur prej të shoqëruarit, arrestuarit/ndaluarit është njoftuar dhe gjendet përpara ambienteve të policisë (porta hyrëse e godinës së policisë), ai duhet të lejohet të takojë e komunikojë me klientin e tij, si dhe të marrë pjesë gjatë kryerjes së veprimeve procedurale të arrestimit/ndalimit, ose gjatë marrjes së deklaratimeve të tij, etj. Nga ky rregull bën përjashtim vetëm nxjerrja e të arrestuarit/ndaluarit nga dhoma e sigurisë për të kryer takime me avokatin mbrojtës, veprime hetimore procedurale (marrja në pyetje, paraqitje për njohje etj) gjatë natës/kohës së pushimit nga ora 22.00-06.00, ndalim i cili parashikohet në kapitullin VII, pika 1.5 e procedurës standarde¹².

c) nëse avokati i zgjedhur prej personit, nuk ndodhet aty, ai duhet të njoftohet menjëherë, nëpërmjet telefonit ose me mënyra të tjera nga punonjësit e policisë për të marrë takim e komunikuar me të shoqëruarin, arrestuarin/ndaluarin apo për të qenë i pranishëm gjatë kryerjes së veprimeve procedurale që do të kryhen me të.

ç) e drejta e komunikimit dhe mbrojtjes me avokat duhet të garantohet për të gjithë personat e shoqëruar pa dallim lidhur me shkakun e shoqërimit, pra si person i dyshuar si autor i ndonjë vepre penale apo për kryerjen e ndonjë kundërvajtjeje administrative.

d) të drejtën e zgjedhjes së avokatit e ka vetë personi i shoqëruar, arrestuar apo ndaluar. Kërkimi i pajisjes me prokurë të avokatit nga disa punonjës të policisë gjyqësore është i pambështetur në ligj sepse nuk është parashikuar në asnjërën prej dispozitave të akteve normative të cituara më sipër. Punonjësit e policisë kanë të drejtën që t'i kërkojnë prokurë avokatit në rastet kur subjektet në fjalë janë të mitur apo nën kujdestari, të cilët nuk kanë zotësinë e plotë për të vepruar.

¹² VII. Rregullat për trajtimin dhe kushtet e jetesës në dhomat e sigurisë

1. Orari i veprimeve dhe koha e pushimit.

.....

1.5 Ndalohet nxjerrja e të arrestuarit/ndaluarit nga dhoma e sigurisë për të kryer takime me avokatin mbrojtës, veprime hetimore procedurale (marrja në pyetje, paraqitje për njohje etj) gjatë natës/kohës së pushimit nga ora 22.00 - 06.00.

Në vlerësim jo vetëm të këtij rasti, por edhe të hetimeve administrative të mëparshme, çmujmë se qëndrime të tilla të strukturave të Policisë së Shtetit, vijnë për disa shkaqe sikurse mund të përmendim:

a) mos njohjes së dispozitave kushtetuese e ligjore nga disa punonjës të policisë dhe drejtues të saj.

b) edhe në rastet kur dispozitat kushtetuese dhe ligjore njihen, jo gjithmonë ato zbatohen, sepse prania e avokatit shikohet si “pengesë” e punonjësve të policisë për të “punuar lirisht” me të shoqëruarit dhe arrestuarit/ndaluarit. Në kushtet kur avokati nuk është i pranishëm, punonjësit e policisë mund t’i pyesin këta shtetas dhe të marrin deklarime për veprën penale për të cilën dyshohen ose kanë kryer, për vepra të tjera për të cilat ata kanë të dhëna operative, mund të kalojnë afatin ligjor të mbajtjes në ambientet e policisë, mund të bëjnë kontroll të banesës, lokalit, bllokime, sekuestrime dhe veprime të tjera arbitrare, sikurse edhe ka ndodhur jo rrallëherë, madje mund të përdorin edhe dhunën psikologjike apo fizike për të realizuar qëllimin e tyre të pranimit të fajësise nga të dyshuarit e kategorisë së mësipërme.

c) shoqëria shqiptare dhe organet shtetërore (përfshi këtu edhe Policinë e Shtetit) nuk kanë kulturën dhe përvojën e duhur bashkëkohore për të kuptuar rolin dhe misionin e avokatisë në procesin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit.

ç) ekzistencës së mentalitetit/mendësisë veçanërisht në strukturat e policisë, që mbrojtja (avokati) të vlerësohet njësh me krimin, me korrupsionin dhe si burim i të gjitha të këqijave në punën e tyre kundër kriminalitetit.

Në përmbyllje të hetimit tonë administrativ, lidhur me mosrespektimin e detyrimeve ligjore për praninë e avokatit në ambientet e policisë gjatë shoqërimit, arrestimit ose ndalimit të shtetasve, gjykojmë se vijnë disa pasoja, sikurse janë:

a) i hapet rruga arbitraritetit, duke shkelur të drejtat ligjore të personit. Tashmë është historikisht e njohur tendenca e çdo pushteti (funksioni shtetëror) për të rënë në pozita arbitrariteti, përmasat e të cilit kushtëzohen nga civilizimi i tërë shoqërisë. Sa më e civilizuar të jetë ajo, aq më e vogël do të jetë tendenca e pushtetarëve për të rënë në arbitraritet. Arbitrariteti vjen jo vetëm nga paaftësia profesionale, por në disa raste edhe nga dëshira ose detyrimi i eprorëve për të zbuluar veprat penale të ndodhura, pa përfillur e respektuar normat ligjore e të drejtat themelore të njeriut.

b) duke u kryer veprime procedurale të pambështetura apo në kundërshtim me ligjin nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore, atëherë ato e humbasin vlerën e provës dhe do të zhvlerësohen nga ana e gjykatës gjatë procesit gjyqësor. Punonjësit e policisë gjyqësore në veprimtarinë e tyre duhet të mbajnë gjithmonë parasysh pikën 2 të nenit 32 të Kushtetutës, ku përcaktohet se: *“askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme”*.

Ju sjellim në vëmendje se, në Raportin e Komitetit European për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT) të Këshillit të Evropës, i bërë publik në datën 17.09.2019, është rekomanduar që autoritetet shqiptare duhet të bëjnë përpjekje të

mëtejshme për të siguruar që e drejta e njoftimit të familjarëve nga personat e privuar nga liria në stacionet e policisë të garantohet në praktikë që nga fillimi i heqjes së lirisë. Gjithashtu, CPT u rekomandon autoriteteve shqiptare t'u kujtojnë të gjithë oficerëve të policisë detyrimin ligjor për t'u dhënë shtetasve që nga fillimi i heqjes së lirisë qasje në një avokat (që përfshin të drejtat për të folur me avokatin privatisht dhe për ta pasur atë të pranishëm gjatë pyetjes).

Për më tepër, në pjesën e raportit që ka të bëjë me Policinë e Shtetit¹³, shkronja “A”, përshkruhen konstatimet dhe rekomandimet për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar. Disa nga rekomandimet që kanë të bëjnë me masat mbrojtëse kundër keqtrajtimit dhe hetimin e ankesave ndaj Policisë së Shtetit, janë si më poshtë:

“A. Ndalimi nga Policia

3. Masat mbrojtëse kundër keqtrajtimit

a. Njoftimi

21. Sipas nenit 255 (4) të Kodit të Procedurës Penale (KPP), policia me pëlqimin e të arrestuarit ose të ndaluarit, duhet të njoftojë pa vonesë familjen e personit.

Shumica dërrmuese e personave të ndaluar të takuar nga delegacioni gjatë vizitës e konfirmuan këtë. Ata kishin patur mundësinë për të informuar të afërmit për situatën e tyre, ose ky njoftim ishte bërë nga një oficer policie, menjëherë pas privimit të lirisë. Sidoqoftë, ka patur disa pretendime se njoftimi ishte vonuar nga oficerët e policisë për disa orë (p.sh. deri në marrjen e një deklaratë zyrtare ose pas takimit me një avokat). CPT rekomandon që autoritetet shqiptare duhet të bëjnë përpjekje të mëtejshme për të siguruar që e drejta e njoftimit të familjarëve nga personat e privuar nga liria në stacionet e policisë të garantohet në praktikë që nga fillimi i heqjes së lirisë.

b. Aksesi në avokat

22. Në përgjithësi, nga informacioni i mbledhur gjatë vizitës, rezultoi se personave të ndaluar që dëshironin të përfitonin nga kjo e drejtë u ofrohej në shumicën e rasteve mundësia për t'u konsultuar me një avokat (përfshirë edhe një avokat i caktuar ex officio) si dhe prania e tij gjatë marrjes në pyetje nga punonjësit e policisë.

Megjithatë, e ngjashme me situatën e vërejtur gjatë vizitave të mëparshme në Shqipëri, një numër i personave të ndaluar treguan se, pavarësisht se kishin kërkuar një avokat ex officio menjëherë pas kapjes, policia kishte injoruar kërkesën e tyre (ose e kishte pranuar atë vetëm pas një vonese të konsiderueshme) në mënyrë që të ishin në gjendje t'i pyesin ata në mënyrë

¹³ Për më shumë shih:

<https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

jozyrtare në lidhje me veprën e dyshuar pa praninë e avokatit (para marrjes së një deklaratë zyrtare). Siç është treguar më lart, disa prej tyre pretenduan të jenë keqtrajtuar fizikisht ose të jenë kërcënuar gjatë kohës kur janë marrë në pyetje informalisht.

Delegacioni gjithashtu dëgjoi ankesa nga personat e ndaluar, të cilëve u ishte siguruar avokat kryesisht (ex officio), por ata nuk kishin patur një konsultim privat me ta gjatë kohës së ndalimit dhe se roli i avokatëve ishte në thelb i kufizuar në nënshkrimin e dokumenteve pjesë e protokollit të intervistës policore. Për më tepër, në disa raste personat e ndaluar kanë marrë kontakt me avokatin e caktuar kryesisht, për herë të parë vetëm në daljen para gjykatës.

Në dritën e sa më sipër, CPT-ja përsërit rekomandimin e saj që autoritetet shqiptare t'u sjellin në vëmendje të gjithë oficerëve të policisë detyrimin ligjor për t'i dhënë shtetasve që nga fillimi i heqjes së lirisë qasje në një avokat (që përfshin të drejtat për të folur me avokatin privatisht dhe për ta pasur atë/të pranishëm gjatë pyetjes).

d. Informimi mbi të drejtat

24. Një numër i personave të ndaluar pretenduan se atyre u ishte dhënë fleta e informacionit që përcakton të drejtat e tyre themelore vetëm në fund të ndalimit të policisë, zakonisht kur nënshkruanin protokollin e intervistës dhe jo në fillim të heqjes së lirisë (p.sh. gjatë ose menjëherë pas kapjes).

CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat të ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i privimit të lirisë (d.m.th., nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici). Kjo duhet të sigurohet me dhënie të një informacioni verbal të qartë që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit për të drejtat e tyre). Personave në fjalë duhet t'u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit për të drejtat e tyre.

Në gjykimin tonë, praktika e deritanishme ka treguar se një mori çështjesh penale të rëndësishme kanë dështuar si rezultat i kryerjes së veprimeve jo profesionale dhe të pabazuara në ligj të punonjësve të policisë gjyqësore. Ndërmjet shkeljeve ligjore, janë konstatuar edhe raste të kryerjes së veprimeve procedurale pa pjesëmarrjen e avokatit mbrojtës.

Është rasti të theksojmë se shkeljeve ligjore, për mos lejjimin e avokatit në ambientet e policisë për të mbrojtur shtetasit e shoqëruar apo të arrestuar/ndaluar, duhet t'u jepet fund. Veprimet e punonjësve të policisë gjyqësore dhe e drejtuesve të tyre, përveç se vijnë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese e ligjore të cituara më sipër, cenojnë imazhin dhe ulin besimin publik të Policisë së Shtetit, si një nga organet e rëndësishëm të administratës shtetërore.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”,* dhe në nenin 21/b, të ligjit nr. 8454 datë 4.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”,* i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:*

b. paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive;”

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për respektimin me rigozitet të kritereve ligjore gjatë shoqërimit të shtetasve në organet e Policisë së Shtetit.
2. Marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e detyrimeve ligjore për plotësimin e Formularit të Raportit të Shoqërimit në çdo rast shoqërimi të shtetasve sapo ata sillen në organin e Policisë, pavarësisht moshës së tyre.
3. Marrjen e masave të nevojshme për kryerjen sa më shpejtë të vizitave mjekësore shtetasve të arrestuar/ndaluar dhe plotësimin e kartelave mjekësore të tyre brenda afatit ligjor prej 12 orë nga arrestimi/ndalimi.
4. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen e shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar me mjetet mbrojtëse anti COVID-19, si maska, dezinfektantë, detergjente, etj, konform akteve normative në fuqi.
5. Marrjen e masave të nevojshme për trajnimin në vazhdimësi të punonjësve të Policisë për përdorimin e forcës dhe të mjeteve në dispozicion në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
6. Marrjen e masave të nevojshme organizative për të reduktuar mbipopullimin e ambienteve të sigurisë sidomos në rastet e shoqërimeve dhe arrestimeve masive duke i transferuar ata në organet e tjera të Policisë së Shtetit.
7. Marrjen e masave të nevojshme për të respektuar të drejtat e personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar, si lejimin e avokatëve të takohen me këto subjekte në çdo kohë dhe sa herë kërkohen prej tyre, sigurimin e psikologëve dhe avokatëve që në momentet e para të shoqërimit të të miturve, si dhe njoftimin sa më shpejtë të familjarëve për vendndodhjen e tyre.
8. Analizimin e rasteve të shkeljeve ligjore të përmendura më sipër, si tejkalimi i përdorimit të forcës, mos plotësimi i Formularit të Raportit të Shoqërimit për të miturit, mos evidentimi i të miturve në regjistrin tip dhe mos plotësimi i kartelave mjekësore, fillimin e ecurisë disiplinore dhe marrjen e masave përkatëse ndaj personave përgjegjës, si dhe përgjithësimin e tyre me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të ktheni përgjigje brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA